



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023  
Ref. KM-281/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Karate Zeon 5 CS** i prodhuesit **“Syngenta Crop Protection AG”**, Zvicër nga përfaqësuesi i saj **“Fitofarma” SH.PK, Ferizaj**.
2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Insekticid
3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Lambda cyhalothrin.....50g/l
4. **PËRDORIMI:**
  - a) **KULTURAT BUJQËSORE:** Pemë frutore, Ulli, Agrume, Vresht, Bimë të arave dhe Perime.
  - b) **DËMTUESIT:** Përdoret për luftimin e insekteve që futen në rendet: Coleoptera, Lepidoptera, Hemiptera, Diptera, Orthoptera dhe Thysanoptera. Paralelisht ul popullatat e akarjeve tek pjeshka, vreshti, pambuku, perimet dhe shumë shpesh edhe tek molla. Vepron nëpërmjet kontaktit dhe aparatit tretës.
  - c) **DOZA:** Zakonisht përdoret 20 ml preparat për 100 litra ujë. Për luftimin e buburrecit të patates dhe tenjës së ullirit doza ulet në 15 ml preparat për 100 litra ujë. Për luftimin e pleshtit të dardhës doza rritet në 40 ml preparat për 100 litra ujë. Doza më e lartë 40-50 ml preparat për 100 litra ujë përdoret për luftimin e krimbit të boçës dhe krimbit të kuq në pambuk dhe në perimet.

**d) SASIA E TRETËSIRËS SPËRKATËSE PËR 1 DYNAM:**

- Në pemët frutore, ulli, agrume dhe vresht 100-200 litra.
- Në kulturat e tjera 50-100 litra.

**5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:**

10ml,20ml,50ml,250ml,1L,5L

**6.VËREJTJE:**

Nuk ka.

**7. KARENCA:**

Në perimet, pemët frutore, vresht dhe agrume: 7 ditë.

Në patate dhe grurë: 1 ditë.

Në misër, sojë, pambuk dhe ulli: 15 ditë.

Në luledielli: 21 ditë.



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)

**8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:**



GHS09-paralajmerim(cat1)-irrezikshëm për ambient

**9. VENDI I SHITJËS:** Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**10.** Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

**11.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:*

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.



**Faton Peci**

**Ministër**